

URDHËR
Nr. 12, datë 11.1.2024

**PËR PUBLIKIMIN E THIRRJES PËR PËRFITIMIN E MBËSHTETJES
FINANCIARE, LIDHUR ME PROJEKTET NË FUSHËN E TURIZMIT PËR VITIN
2024**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 31, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar; të pikave 8 dhe 10, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 13.4.2016, “Për përcaktimin e kriterëve e të afateve të kërkesëpropozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e publikimit e thirrjes për përfitimin e mbështetjes financiare, lidhur me projektet në fushën e turizmit për vitin 2024.
 2. Miratimin e procedurave për përfitimin e mbështetjes financiare, lidhur me projektet në fushën e turizmit, sipas formatit bashkëlidhur këtij urdhri.
 3. Publikimin e procedurës për përfitimin e mbështetjes financiare, në lidhje me projektet në fushën e turizmit, në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.
 4. Ngarkohen Drejtoria e Zhvillimit të Programeve të Turizmit, si dhe Drejtoria e Financës dhe Menaxhimit të Buxhetit për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi

NJOFTIM
Nr. 249, datë 11.1.2024

**PËR PUBLIKIMIN E THIRRJES PËR PËRFITIMIN E MBËSHTETJES
FINANCIARE TË PROJEKTEVE NË FUSHËN E TURIZMIT**

THIRRJA PËR APLIKIM

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit shpall thirrjen për përfitimin e mbështetjes financiare të projekteve në fushën e turizmit, të paraqitura nga persona fizikë dhe juridikë, vendës apo të huaj, privatë ose publikë, të cilët kanë në objekt të veprimtarisë së tyre turizmin, në funksion të realizimit të misionit strategjik:

“Shqipëria, një destinacion mikëpritës, tërheqës dhe autentik, për zhvillim të qëndrueshëm të potencialeve ekonomike, natyrore dhe sociale të vendit”

Thirrja synon promovimin e destinacioneve, produkteve dhe diversifikimin e ofertës turistike për zhvillimin e turizmit malor, natyror, kulturor, tradicional, kulinar, ekoturizmit, turizmit nostalgjik, turizmit të aventurës etj., në mbështetje të veprimtarive të sezonit turistik për vitin 2023.

Thirrja do të qëndrojë e hapur nga data **15 janar deri më datën 13 shkurt të vitit 2024**. Projektet duhet të realizohen brenda vitit buxhetor, nga data e nënshkrimit të kontratës deri më 15.11.2024.

Tematika e thirrjes për mbështetje financiare të projekteve në turizëm është:

- Për zhvillimin dhe promovimin e destinacioneve, produkteve të diversifikuara të ofertës turistike dhe mjedisore në turizëm.

Atraksionet turistike prezantohen dhe lidhen me një sërë tiparësh dalluese materiale, intelektuale dhe emocionale të një shoqërie që përfshin trashëgiminë historike dhe zonat kulturore,

gastronominë, letërsinë, industrinë krijuese dhe kulturat e gjalla me stilin e tyre të jetesës, sistemet e vlerave, besimet dhe traditat.

Promovimi i destinacioneve turistike, edukimit mjedisor dhe vlerave të veçanta lokale nëpërmjet zhvillimit të eventeve tradicionale dhe inovative të aktivitetit shpirtëror njerëzor, nxit dhe motivon pjesëmarrjen aktive të turistëve në përvojat shqiptare, atraksionet dhe potencialet e prekshme dhe të paprekshme të destinacioneve turistike.

FORMULARI I APLIKIMIT

PËR PËRFITIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE LIDHUR ME PROJEKTET NË FUSHËN E TURIZMIT

PJESA I: INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Titulli i projektit	
Emri i aplikantit	
Statusi ligjor (së bashku me ndryshimet që kanë pësuar aktet themelore të organizatës, duke bashkëngjitur vendimet përkatëse të gjykatës nr.)	Numri i vendimit dhe data e regjistrimit në gjykatë NIPT-i Emri i Bankës Numri IBAN Nr. i llogarisë bankare (në lek)
Adresa:	
E-mail:	
Website:	
Nr. tel.:	
Kohëzgjatja e projektit	< datë/muaj nga/deri >
Vendi/et ku zbatohet projekti	
Personi i kontaktit	
Funksioni:	
Buxheti total:	
Fondet e kërkuara nga MTM-ja	
Informacion për bashkëfinancim	
Partnerët e projektit:	

PJESA II: PËRSHKRIMI I PROJEKTT

Titulli i projektit:

Qëllimi i projektit: Përshkruani shkurtimisht projektin, problematikën që ai adreson, si dhe argumentimin se si projekti u përgjigjet nevojave të identifikuara (*maksimumi 10 rreshta*).

[shpjegoni...]

Objektivat e projektit (*maksimumi 5 rreshta për secilin objektiv*):

1. [shpjegoni...]

2. [shpjegoni...]

3. [shpjegoni...]

Etj.

Aktivitetet kryesore të projektit (*maksimumi 5 rreshta përshkrim për secilin aktivitet, të planifikuara në çdo fushë*)

1. [shpjegoni...]

2. [shpjegoni...]

3. [shpjegoni...]

Etj.

A janë aktivitetet e propozuara të përshtatshme, praktike dhe në përputhshmëri me objektivat dhe rezultatet e pritura? (*maksimumi 5 rreshta*)

[shpjegoni...]

A është projekti/prodakti objektivisht i verifikueshëm lidhur me rezultatet e aktiviteteve?

(maksimumi 3 rreshta për secilin aktivitet)

Aktiviteti 1:

Projekti/prodakti rezultatet e pritura dhe treguesit lidhur me: [shpjegoni...]

Aktiviteti 2:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [shpjegoni...]

Aktiviteti 3:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [shpjegoni...]

* Plotëso: Tabelën për aktivitet/ nënaktivitetet e projektit

Aktiviteti (përshkrimi)	Qyteti	Vendi/ data/ora	Periudha	Fusha/ gjinia	Nr. i audiencës (parashikim)	Nr. i personave të angazhuar (pagesa bonorar)	Partneri zbatues

Shënim:

- Ju lutem, shënoni **aktivitetin** me të gjitha të dhënat që kërkohen.

Cili është grupi ose cilat janë grupet e synuara? (Lutemi të përshkruani shkurtimisht, në mënyrë sa më të përmblëdhur, se cili është grupi parësor i synimit të projektit dhe se si kanë për t'i shërbyer aktivitetet e projektit.) Maksimumi 5 rreshta: [shpjegoni...]

Qëndrueshmëria e projektit – impakti afatgjatë i projektit nga pikëpamja e problematikës së adresuar, fushës së zhvillimit të projektit, si dhe individit ose organizatës që e propozon.

Maksimumi 5 rreshta: [shpjegoni...]

Në konceptimin, hartimin dhe zbatimin e projektit, a është respektuar e drejta e autorit?

Maksimumi 5 rreshta: [shpjegoni...]

PJESA III: PARTNERËT (NËSE KA)

Bashkërendimi i punës midis partnerëve. (Përshkruani natyrën e partneritetit. Shpjegoni bashkërendimin e punës midis partnerëve duke përshkruar procesin e vendimmarrjes, si dhe funksionin dhe përgjegjësitë e secilit partner në zbatimin e projektit.) Maksimumi 5 rreshta: [shpjegoni...]

Partneri 1 (aplikanti)

Misioni. Cili është misioni i organizatës suaj?

Maksimumi 5 rreshta: [shpjegoni...]

Struktura. Përshkruani strukturën e organizatës, duke përfshirë detaje, si numrin e të punësuarve dhe strukturën e menaxhimit.

Maksimumi 5 rreshta: [shpjegoni...]

Financimi. Si financohet organizata juaj dhe cili ishte buxheti i saj për vitin paraardhës?

Maksimumi 5 rreshta: [shpjegoni...]

Partneri 2

Emri i organizatës: [shpjegoni...]

Personi i kontaktit: _____

E-mail: _____

Adresa: _____

Faqja në internet: _____

Etj.

PJESA IV: BUXHETI

Lutemi të përshkruani shpenzimet e përfshira për implementimin e projektit. Çfarë burimesh të fondeve të tjera janë të siguruar dhe të mundshme?

Emri i aplikantit:

Titulli i projektit:

Koha e zbatimit: nga/deri

Nr.	Lloji i shpenzimit	Njësia	Sasia	Çmimi në Lekë	TOTAL	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Vetë aplikanti	Donatorët e tjerë -I-	Donatorët e tjerë -II-
SHPENZIMET SIPAS AKTIVITETEVE DHE ZËRAVE PËRKATËS									
1	Titulli i shpenzimit 1								
	Shembull: Promocion dhe përgatitje (ftesa, poster, baner, programi) të specifikuar sipas përshkrimit të eventit dhe vendit								
1.1	Dizajni i ftesës								
1.2	Printime	cope	100	200.00	2,000.00				
1.3	etj								
	TOTAL 1			200.00	2,000.00				
2	Titulli i shpenzimit 2 (shembull Realizimi i aktiviteti)								
2.1	Shpenzime salle								
2.2	Shpenzime akomodimi								
2.3	etj								
	TOTAL 2			-	-				
3	Titulli i shpenzimit 3								
3.1									
3.2									
etj.									
	TOTAL 3			-	-				
4	Titulli i shpenzimit 4								
4.1									
4.2									
etj.									
	TOTAL 4			-	-				
	TOTALI I SHPENZIMEVE (në Lekë dhe në %)								

Ju lutem shtoni linja buxhetore për çdo aktivitet

Sqarim:

- Ju lutemi, të llogaritni shumën totale që mbulon çdo donator (duke përfshirë Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe vetë aplikantin, si % e buxhetit total për projektin;
- Vlerat financiare të paraqitura në këtë formular duhet të jenë të përcaktuara në lek;

PROCEDURA

Procedura e aplikimit bazohet në kriteret dhe afatet e përcaktuara në vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 13.4.2016, “Për përcaktimin e kriterëve e të afateve të kërkesëpropozimeve për mbështetje financiare të projekteve në fushën e turizmit”.

I. Dokumentacioni

1. Të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm lidhur me statusin e tyre juridik provuar me ekstraktin e regjistrimit dhe ekstraktin historik, si subjekt, NUIS-in, sa vijon;

a) Vërtetim nga Gjykata që nuk janë në proces falimentimi dhe a/1) vërtetim nga Zyra Përmbarimore se kapitalet e tij nuk janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit;

b) Vërtetim nga Gjykata që nuk janë subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe b/1) Vërtetim nga Gjykata që nuk ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi, ose nuk ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme;

c) Vërtetim nga Gjykata dhe c/1) vërtetim të gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) që nuk janë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale, si person juridik, ortak apo aksionar i shoqërisë;

d) Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve që kanë përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

e) Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve që kanë përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës.

2. Dokumentacionin që demonstrojnë që janë në gjendje të financojnë 100% të të gjitha kostove të projektit të propozuar përpara përfundimit të tij, konkretisht:

a) Kopje të certifikuara të balanceve të 2 (dy) viteve të fundit, të paraqitura në autoritetet përkatëse;

b) Raportet e auditit financiar, të certifikuara nga një subjekt i licencuar auditimi;

c) Kopje të deklaratave të xhiros vjetore.

3. Në formularin e aplikimit të paraqesin argumente në mbështetje të propozimeve, që justifikojnë financimin e projekteve të rëndësishme të paraqitura prej tyre, si dhe argumente që çmimet janë të bazuara në referenca.

4. Në aplikimin e paraqitur nga subjektet aplikuese duhet të parashikohen edhe shpenzimet për auditimin e projektit.

5. Aplikuesi duhet të paraqesë edhe dokumentet e mëposhtme:

a) Nëse aplikon si person fizik, duhet të paraqitet një CV dhe një portofol i veprimtarisë së aplikuesit;

b) Nëse aplikon si person juridik, duhet të paraqitet një CV e subjektit dhe një portofol i veprimtarisë së tij të deritanishme;

c) Vërtetim i llogarisë bankare të aplikantit;

d) Konfirmim për bashkëfinancimin e projektit të propozuar (nëse ka);

e) Deklaratë e aplikuesit, që nuk detyrohet për auditim ligjor të pasqyrave financiare (kur kjo është e aplikueshme).

** Kur aplikuesi është i huaj ai duhet të vërtetojë që i plotëson të gjitha kriteret e vendimit nr. 281, datë 13.4.2016, si dhe dokumentacionin e renditur më sipër. Nëse dokumentet e sipërpërmendura nuk lëshohen në shtetin e origjinës, atëherë mjafton një deklaratë noteriale me shkrim nga ana e tij.*

II. Metoda e aplikimit

Formulari i aplikimit i plotësuar, së bashku me dokumentacionin mbështetës duhet të dorëzohen dorazi ose me postë, brenda datës 20 qershor 2023, pranë Protokollit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në adresën:

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 1, 1001, Tiranë

Sipër zarfit të shkruhet qartësisht:

Drejtuar: Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit; aplikim për përfitim të mbështetjes financiare në fushën e turizmit; emri i aplikantit; titulli i projektit.

Sqarojmë se dokumentacioni i dorëzuar nuk mund të tërhiqet, por në rast interesi u vihet në dispozicion fotokopje e tij.

III. Financimi

Thirrja për përfitim të mbështetjes financiare për vitin 2023, në kuadër të zhvillimit të programeve në fushën e turizmit, financohet nga fondi buxhetor i miratuar për vitin kalendarik.

Për realizimin e projekteve konkurruese turistike, skema e financimit do të mbulojë deri në 50% të kostove të projektit të pranuar e të miratuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Projektet për të cilat kërkohet një financim që kalon 50% të fondit buxhetor vjetor të parashikuar në buxhetin e shtetit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Financimi nga Buxheti i shtetit nuk mund të jepet më tepër se një herë në vit për të njëjtin subjekt konkurrues.

Shpenzimet e nevojshme për shpërblimin e ekspertëve të pavarur do të mbulohen nga fondi buxhetor i parashikuar për mbështetjen financiare të projekteve turistike.

Ky fond shkon për projekte që zhvillohen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

IV. Vlerësimi i kërkesëpropozimeve

Vlerësimi do të kryhet nga Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm i ngritur me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 121, datë 1.3.2023, "Për një ndryshim në vendimin nr. 325, datë 31.5.2018, 'Për përcaktimin e anëtarëve të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm'".

Komisioni klasifikon dhe përzgjedh projektet në fushën e turizmit brenda 5 (pesë) ditëve pune, pas përfundimit të afatit 30-ditor (tridhjetëditor) të parashikuar për paraqitjen e dokumentacionit nga

subjektet e interesuara që kanë paraqitur kërkesë propozime për mbështetje financiare. Procesi i përzgjedhjes së kërkesë propozimeve kryhet në fazat e mëposhtme:

- Vlerësimi i personit fizik/juridik dhe i dokumentacionit të dorëzuar për plotësimin e kritereve;
- Vlerësimi i përmbajtjes së projektit për subjektet që kanë dorëzuar dokumentacionin e plotë.

Ministri, brenda 3 (tri) ditësh pas paraqitjes së propozimeve nga Komisioni, miraton projektet në fushën e turizmit, të cilat do të përfitojnë financim.

Nëse kërkesë propozimi përzgjidhet nga Komisionin i Përzgjedhjes së Projekteve dhe miratohet nga ministri, procedohet me njoftimin e aplikuesit brenda 5 (pesë) ditëve për nënshkrimin e kontratës.

Nënshkrimi i kontratës kryhet nga ministri ose një person tjetër i autorizuar prej tij.

Procesi i monitorimit të realizimit të projektit të përzgjedhur kryhet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit pas lidhjes së kontratës dhe fillimit të projektit.